



Bazuar në nenin 35, paragrafi 1, nënparagrafi 1.1, të Ligjit Nr. 03/L-209 për Bankën Qendrore të Republikës së Kosovës (Gazeta Zyrtare e Republikës së Kosovës, nr. 77/16 gusht 2010) ,si dhe në nenin 4, paragrafi 3, nenin 90, nenin 91, paragrafi 4, dhe nenin 92, paragrafi 3, të Ligjit Nr. 05/L-045 për Sigurimet (Gazeta Zyrtare e Republikës së Kosovës, nr. 38/24 dhjetor 2015), Bordi i Bankës Qendrore në mbledhjen e mbajtur më 30 nëntor 2017, miratoi:

## **RREGULLORE PËR MBIKËQYRJEN E KONSOLIDUAR TË GRUPEVE TË SIGURUESVE**

### **Neni 1**

#### **Qëllimi dhe fushëveprimi**

1. Qëllimi i kësaj rregulloreje është që të përcaktojë mbikëqyrjen e konsoliduar të grupeve të siguruesve.
2. Dispozitat e kësaj rregulloreje zbatohen për të gjithë siguruesit e licencuar nga BQK-ja, që operojnë në Republikën e Kosovës.

### **Neni 2**

#### **Përkufizimet**

1. Të gjitha termet e përdorura në këtë rregullore kanë kuptimin të njëjtë siç janë përcaktuar në nenin 3 të Ligjit Nr. 05/L-045 për Sigurimet (me tutje: Ligji për Sigurimet) dhe/ose siç përcaktohet më poshtë për qëllimet e kësaj rregulloreje.
  - a) "*Kompani holding*" është një kompani mëmë që zotëron aksione në një kompani tjetër që i mundëson kontrollimin e politikave dhe menaxhimit të saj.
  - b) "*Grup*" nënkupton një grup biznesor i përbërë nga kompania mëmë, kompanitë e kontrolluara të saj si dhe të gjithë subjektet mbi të cilat kompania mëmë apo kompania e kontrolluar e saj ushtron interes të konsiderueshëm apo zotëron pjesëmarrje.
  - c) "*Kompania mëmë*" është një njësi ekonomike që ka një ose më shumë filiale.
  - d) "*Filial*" është një njësi ekonomike, e cila kontrollohet nga një njësi tjetër ekonomike të njohur si kompania mëmë.
  - e) "*Kompani të lidhura*" është një lloj i marrëdhënies, në të cilën një nga kompanitë zotëron më pak se shumica e aksioneve të kompanisë tjetër, ose një lloj i marrëdhënies, në të cilën të paktën dy kompani të ndryshme janë filiale të një kompanie të madhe.

- f) *“Mbikëqyrja e konsoliduar”* është një vlerësim i përgjithshëm - si sasi or po ashtu edhe cilësor - i fuqisë financiare të një grupi të cilit një sigurues i takon, që ka për qëllim për të vlerësuar ndikimin e mundshëm të kompanive të tjera të grupit në siguruesin.
- g) *“Pasqyra financiare të konsoliduara”* janë pasqyrat financiare të një grupi të paraqitura si pasqyrat financiare të një njësie të vetme ekonomike.
- h) *“Pasqyra financiare individuale”* janë pasqyrat financiare që paraqiten nga një shoqëri mëmë, një investitor në një pjesëmarrje ose një sipërmarrës në një njësi ekonomike të kontrolluar bashkërisht, në të cilën investimet janë llogaritur në bazë të interesit direkt të kapitalit neto dhe jo mbi bazën e rezultateve të raportuara dhe aktivet neto të njësisë ku është investuar.

### **Neni 3**

#### **Mbikëqyrja e konsoliduar e siguruesve në grup**

1. Mbikëqyrja e konsoliduar e siguruesve në grup bëhet me qëllim të monitorimit të gjendjes financiare të siguruesve në grup dhe mbrojtjen e të siguarve dhe kreditorëve nga rreziqet, të cilave siguruesi iu ekspozohet si rezultat i lidhjeve me entitete tjera në grup. Mbikëqyrja e konsoliduar e siguruesve në grup nënkupton mbikëqyrjen e konsoliduar të gjendjes së përgjithshme të siguruesve dhe ka të bëjë me standardet e mbikëqyrjes për:
  - a) kalkulimin e konsoliduar të fondeve të veta;
  - b) kalkulimin e konsoliduar të raportit të aftësisë pagueese;
  - c) kontrollin e konsoliduar të mjaftueshmërisë së fondeve të veta për të mbuluar rreziqet e tregut;
  - d) kontrollin e konsoliduar të ekspozimit ndaj rrezikut;
  - e) kufizimet e konsoliduara për investime nga institucionet kreditore jashtë sektorit të sigurimeve;
  - f) mbikëqyrja e konsoliduar gjithashtu aplikohet në grupet të cilat përfshijnë firmat investuese.
2. Mbikëqyrja e konsoliduar e siguruesve në grup përfshin:
  - a) mbledhjen dhe verifikimin e informatave që janë të nevojshme për qëllimet e mbikëqyrjes;
  - b) mbikëqyrjen e transaksioneve ndërgrupore të parapara me nenin 91 të Ligjit për Sigurimet;
  - c) mbikëqyrjen e mjaftueshmërisë së kapitalit të grupit;
  - d) ndërmarrjen e masave korrigjuese në rast të rrezikimit të siguruesit në një grup që rezulton nga aktivitetet ose gjendja financiare e ndonjë siguruesi tjetër në grupin e siguruesve.
3. Sipas nenit 91 të Ligjit për Sigurimet, siguruesit që janë pjesë e grupeve të sigurimeve, raportojnë në baza vjetore në BQK, të gjitha transaksionet ndërgrupore. BQK-ja do të ushtrojë mbikëqyrje mbi transaksionet e rëndësishme sipas përcaktimeve të nenit 91, paragrafët 2 dhe 3, të Ligjit për Sigurimet.

## Neni 4

### **Shtrirja e mbikëqyrjes së grupit**

1. BQK-ja do të përcaktojë saktësisht shtrirjen e mbikëqyrjes së një grupi të siguruesve për të cilin zbatohet mbikëqyrja e konsoliduar.
2. Me qëllim të vlerësimit të fuqisë së një grupi të siguruesve si tërësi, për BQK-në është e nevojshme të vlerësohen rreziqet në të gjitha pjesët e rëndësishme të grupit. Kjo do të bëhet si në baza kuantitative ashtu edhe në baza kualitative. BQK-ja do të përcaktojë se cilat kompani të grupit paraqesin rrezik të konsiderueshëm dhe t'i paraqes ato në konsolidim. Nëse një anëtar i një grupi nuk ka rrezik të konsiderueshëm dhe lidhjet në mes të kompanive janë të dobëta, mospërfshirja e kompanive të tilla në kuadër të konsolidimit mund të jetë e pranueshme. Kompanitë jofinanciare mund të përjashtohen, vetëm nëse lidhjet janë të dobëta ose rreziqet janë konsideruar si minimale. Kur lidhjet janë të ngushta BQK-ja mund të kërkojë nga siguruesi për të riorganizuar grupin në mënyrë që pjesa financiare të jetë më e pavarur.
3. Kur një grup siguruesish drejtohet nga një sigurues mëmë, mbikëqyrja e konsoliduar është relativisht e qartë dhe do të përfshijë të gjitha filialet e siguruesit dhe kompanitë e lidhura. Por gjithashtu mund të jetë e dëshirueshme që të mbikëqyret një grup në një bazë të konsoliduar, ku mëma është një kompani holding ose entitet tjetër që nuk është vetë subjekt i mbikëqyrjes. Në rast të tillë një grup do të përcaktohet duke përfshirë siguruesin, mëmën dhe kompanitë e tjera të lidhura që sipas BQK-së paraqesin rrezik potencial ndaj të siguarve dhe kreditorëve të siguruesit. Pra, një grup siguruesish do të definohet si përfshirje e të gjitha subjekteve në një kontroll të përbashkët. Kjo nuk e përjashton mundësinë e përfshirjes edhe të kompanive që nuk kanë shumicë në pronësi. BQK-ja do të përdorë teste praktike për të përcaktuar nëse një njësi ekonomike edhe nëse jo shumicë në pronësi, por megjithatë efektivisht kontrollohet nga grupi, potencialisht a i ekspozon në rrezik të siguarit dhe kreditorët e siguruesit.
4. Kur një sigurues është anëtar i një grupi që përfshin një sigurues apo një kompani të huaj, BQK-ja do të konsolidojë vetëm siguruesin dhe çdo kompani të lidhur në Kosovë, pavarësisht nëse ato janë subjekte të varura të siguruesit në Kosovë ose subjekte të varura të degëve të huaja të grupit. BQK-ja pret nga mbikëqyrësit e vendit amë të jenë përgjegjës për mbikëqyrjen e konsoliduar të gjithë grupit siç është përcaktuar me nenin 10, paragrafi 1, i Ligjit për Sigurimet. Para licencimit të një siguruesi të tillë dhe në vazhdimësi BQK-ja do të verifikojë nëse grupi vazhdon të jetë subjekt i mbikëqyrjes efektive të konsoliduar nga mbikëqyrësi i saj në vendin amë. Nëse BQK-ja nuk është e kënaqur mund të marrë hapa për të siguruar se aktiviteti i siguruesit në Kosovë është i izoluar nga zhvillimet gjetiu. Kjo mund të përfshijë ndryshimet në strukturën e aksionarëve të siguruesit.

## **Neni 5**

### **Mbikëqyrja kuantitative**

1. Mbikëqyrja kuantitative e një grupi të siguruesve për qëllim të kësaj rregulloreje nënkupton përgatitjen e pasqyrave financiare të konsoliduara siç kërkohet nga standardi ndërkombëtar i kontabilitetit (SNK) 27 dhe neni 71, paragrafi 2, i Ligjit për Sigurimet. BQK-ja mund të përcaktojë shkallën e konsolidimit për qëllime të kontabilitetit duke u mbështetur në teste, bazuar në SNK 27. Megjithatë, BQK-ja mund t'i përfshijë brenda fushës së saj të mbikëqyrjes së konsoliduar, njësitë ekonomike që nuk janë subjekt i kontabilitetit të konsoliduar. Pra, fakti që një njësi ekonomike nuk është konsoliduar për qëllime të kontabilitetit nuk do të thotë se nuk do të trajtohet si pjesë e grupit për qëllime të mbikëqyrjes së konsoliduar.
2. Nga grupet e siguruesve gjithashtu do të kërkohet të përgatitin dhe të paraqesin në BQK bilancin e gjendjes dhe raporte tjera statistikore në bazë të konsoliduar. Këto do të mundësojnë llogaritjen e raporteve të mjaftueshmërisë së kapitalit për grupin në tërësi në mënyrë që të sigurohet që nuk bëhet numërimi i dyfishtë i kapitalit. Kërkesat dhe detyrimet brenda grupit në këtë proces do të eliminohen. Në rast të subjekteve të varura të siguruesve atëherë investimi në sigurues do të zbritet nga kapitali i kompanisë mëmë me qëllim të përcaktimit të kapitalit të grupit. Për aplikimin e detajuar të kërkesave të mjaftueshmërisë së kapitalit në një grup të siguruesve, siguruesit duhet të veprojnë në përputhje me Rregulloren për Adekuatshmërinë e Kapitalit të Siguruesve.
3. Raportet kuantitative gjithashtu do të mundësojnë llogaritjen e ekspozimeve të mëdha dhe pozicioneve valutore për grupin në tërësi. Ekspozimet e siguruesit ndaj rreziqeve të tregut, do të vlerësohen në bazë të grupit. Rregullorja e BQK-së për ekspozimin e një rasti të vetëm të siguar do të aplikohet për grupet për të cilat BQK-ja ka përcaktuar aplikimin e mbikëqyrjes së konsoliduar.

## **Neni 6**

### **Mbikëqyrja kualitative**

1. Përveç mbikëqyrjes kuantitative, BQK-ja do të marrë në konsideratë edhe aspektet kualitative. Ky proces do të përfshijë përcaktimin e lidhjeve në mes anëtarëve të ndryshëm të një grupi të siguruesve, kuptimin dhe vlerësimin e lidhjeve të menaxhmentit, si dhe lidhjet financiare. BQK-ja mund të kërkojë që një subjekt i varur i siguruesit të një grupi të ketë drejtorë të pavarur në numër të mjaftueshëm në bordin e tij për të vepruar në mënyrë të pavarur nga kompanitë e tjera të grupit dhe në këtë mënyrë të sigurojë që i kushtohet vëmendje e mjaftueshme përgjegjësisë së siguruesit ndaj policëmbajtësve përkatës. Informata e mbledhur në këtë proces do të ndikojë në vendimet e BQK-së se cilët anëtarë të një grupi duhet të përfshihen në grupin e konsoliduar për qëllime të mbikëqyrjes. Kur një grup përbëhet nga një përzjerje e subjekteve financiare dhe subjekteve tjera, BQK-ja mund të kërkojë të përfshihen aktivitetet financiare dhe të përjashtohen subjektet me aktivitet jofinanciar për qëllim të mbikëqyrjes së konsoliduar. Megjithatë, për të bërë këtë BQK-ja duhet të sigurojë që

asnjë lidhje financiare dhe lidhje menaxheriale të mos jetë e tillë që të dëmtoj procesin. Kështu që një nëngrup financiar pritet të ketë drejtorë dhe menaxherë të pavarur, në mënyrë që mos të ndikohet jashtë mase nga menaxhmenti i entiteteve që janë jashtë nëngrupit financiar të konsoliduar.

2. Kjo mund të kërkojë disa ndryshime në mënyrën e strukturimit të një grupi nëse vlerësohet që struktura pengon mbikëqyrjen efektive të konsoliduar.
3. BQK-ja do të përdorë gjithashtu edhe kompetencat e saj kur dyshon se një subjekt i palicencuar brenda një grupi kryen aktivitete të ndaluara me Ligjin për Sigurimet ose në bazë të ligjeve tjera relevante.
4. BQK-ja kërkon që një firmë të jetë përgjegjëse për auditimin e jashtëm të të gjitha kompanive të një grupi dhe jo të mbështetet në punën e disa kompanive audituese.

## **Neni 7**

### **Informatat**

1. Mbledhja e informatave nga ana e BQK-së krijon bazë për mbikëqyrje të konsoliduar. Sipas nenit 90 të Ligjit për Sigurimet, BQK-ja mund të mbledhë informacione nga subjektet e mbikëqyrura brenda një grupi të siguruesve, por edhe nga subjektet tjera të lidhura me subjektin e mbikëqyrur për të përcaktuar shkallën e lidhjes së përshkruar më lart.
2. Kur një grup siguruesish përfshin subjektet e mbikëqyrura apo të rregulluara nga një autoritet tjetër mbikëqyrës në Kosovë apo jashtë vendit, BQK-ja do të mbajë diskutime periodike me autoritetet mbikëqyrëse të tilla, që janë të nevojshme për të kuptuar marrëdhëniet në mes të siguruesve të licencuar në Kosovë dhe të huaja në grup dhe të jetë në gjendje për të parë se sa solvent është grupi dhe komponentët e tij.

## **Neni 8**

### **Procedura për mbikëqyrje të konsoliduar**

Nëse BQK-ja vlerëson se ekziston grupi i siguruesve që kërkon mbikëqyrje të konsoliduar, ajo do të diskutojë me anëtarin kryesor të grupit natyrën e këtyre lidhjeve. Nëse, në bazë të diskutimeve të tilla, BQK-ja konstaton se grupi kërkon mbikëqyrje të konsoliduar, atëherë do të informojë siguruesin me shkrim, duke radhitur subjektet të cilat propozohen për t'u përfshirë në mbikëqyrjen e konsoliduar. Në bazë të konstatimit të tillë vlerësohet nevoja për ndonjë përshtatje konsolidimi për qëllime të kontabilitetit.

## **Neni 9**

### **Zbatimi, masat përmirësuese dhe dënimet civile**

Shkelja e kësaj rregulloreje do të jetë objekt i masave mbikëqyrëse dhe ndëshkimore të parashikuara në nenet 124, 125 dhe 126 të Ligjit për Sigurimet.

**Neni 10**  
**Dispozita kalimtare**

Subjektet e kësaj rregulloreje, jo më vonë se gjashtë (6) muaj pas hyrjes në fuqi të kësaj rregulloreje, duhet të rishikojnë dhe/ose aprovojnë politikat dhe procedurat e brendshme në përputhje me kërkesat e kësaj rregulloreje.

**Neni 11**  
**Shfuqizimi**

Me hyrjen në fuqi të kësaj rregulloreje shfuqizohen të gjitha dispozitat e rregulloreve, rregullave dhe udhëzimeve që rregullojnë mbikëqyrjen e konsoliduar të grupeve të siguruesve.

**Neni 12**  
**Hyrja në fuqi**

Kjo Rregullore hyn në fuqi 15 ditë nga data e miratimit të saj.

Prof. Dr. Bedri Peci  
Kryetar i Bordit të Bankës Qendrore